

**VENDIM**  
**Nr.73, datë 24.6.2008**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S**  
**NR.40, DATË 31.8.2005 “PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT ME**  
**ENERGJI ELEKTRIKE PËR KLIENTIN E KATEGORISË FAMILJARE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 44, pika 1, dhe 45, pika 2, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 2, paragrafi 10 dhe 12 të modelit të tregut të energjisë elektrike të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, dhe neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.6.2008, pasi shqyrtoi propozimin për ndryshimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.40, datë 31.8.2005 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë familjare” dhe konstatoi se:

- ligji për sektorin e energjisë elektrike dhe modeli i tregut të energjisë elektrike përcaktojnë përgjegjësinë e furnizuesit publik me pakicë në furnizimin me energji elektrike të klientëve tariforë;

- OSSH sh.a. është mbajtëse e licencës së furnizimit publik me pakicë;

- deri më tani kontratat e furnizimit me energji të klientëve tariforë janë realizuar nga KESH sh.a., ç’ka nuk i korrespondon ndryshimeve të ndodhura në kuadrin ligjor në sektorin e energjisë elektrike,

për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.40, datë 31.8.2005 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë familjare” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në titullin e vendimit, pas fjalës “familjare” shtohen fjalët: “... nga furnizuesi publik me pakicë OSSH sh.a.”.

2. Në pikën 1 të vendimit, pas fjalës “familjare” shtohen fjalët: “... - nga furnizuesi publik me pakicë (OSSH sh.a.)”.

3. Pas pikës 1 të vendimit shtohet pika 2 me përmbajtjen:

“Në kontratën bashkëlidhur vendimit, kudo ku thuhet “furnizuesi” ose “furnizimi me energji elektrike” do të kuptohet “furnizimi nga furnizuesi publik me pakicë (OSSH sh.a.)”.”.

2. Duke filluar nga data 1 korrik 2008 OSSH sh.a. është përgjegjëse për zbatimin e kontratave të furnizimit me energji elektrike të klientëve familjare, të rinj dhe ekzistues.

3. Ngarkohet furnizuesi publik me pakicë (OSSH sh.a.) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 1 korrik 2008.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**